

**MINISTRIA PËR EUROPËN DHE PUNËT E JASHTME
ARKIVI HISTORIKO - DIPLOMATIK**

Inventari i Dokumentacionit i Vitit 1919 MPJ

AFATI I RUAJTES : I PËRHERSHËM

Nr.	Numri dosjeve	Titulli	Viti (Fillur-Mbaruar)	Sasia e fleteve	Numri i kutise	Shenime
1	8	Viti 1919.				
2	1	Shteti dhe e drejta.				
3	47	Lista e disa dokumentave të Qeverisë Provizore (duhet të jetë kapak dosari).	1919	1	1	Shtesë
4	2	Politika.				
5	1	Korespondencë ndërmjet Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes me delegacione të huaja mbi pretendimet e Greqisë për tokat shqiptare, kërkohet nga ana e delegacionit shqiptar të merren masa dhe të ndërhyet kundër masakrave dhe barbarizmave të grekëve ndaj popullsisë shqiptare.	-	207	1	Ka një listë të dëmeve, shkatërrimeve dhe vrasjeve në popullsinë e fshatrave dhe krahinave të Jugut si dhe lista e Komisionit Ndërkombëtar për këtë çështje.
6	2	Letra e Esat Toptanit dërguar qeverisë greke si dhe Konferencës së Paqes në Paris duke e quajtur vehten si kryetar i Qeverisë Shqiptare, si dhe një shkresë që tregon veprimtarinë antishqiptare të Esat Toptanit që nga koha e Turqisë gjer në kohën e luftës së parë botërore, tradhëtia e tij në luftën e Shkodrës, bashkëpunimi me qeverinë greke etj.	-	7	1	
7	3	Memorandum i Fuqive të Mëdha mbi dhënien e mandatit Italisë mbi Shqipërinë, marrëveshja ndërmjet Qeverisë Provizore dhe përfaqësuesve të Italisë në Shqipëri, mbi administrimin e tokave të okupuara nga forcat italiane, zgjerimi i pushtimit të Shqipërisë së Jugut, organizimi i gjindarmërisë etj. Qëndrimi i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes lidhur me politikën italiane në Shqipëri.	-	367	1	Ka një protestë kundër politikës italiane në Vlorë nga Spiro Koleka dhe Qazim Kokoshi.

Nr.	Numri dosjeve	Titulli	Viti (Fillur-Mbaruar)	Sasia e fleteve	Numri i kutise	Shenime
8	4	Korespondencë ndërmjet Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes Paris,delegacioneve të huaja dhe përfaqësuesve të Korçës, acarimi me forcat franceze. Kërkohet që Korça të bashkohet me Shqipërinë dhe të ndalohen forcat greke që të hyjnë në Korçë.	-	60	1	
9	5	Protestë kundër një artikulli në gazetën franceze " Bota e lirë " ku shkruhet në favor të kërkesave greke ndaj Shqipërisë si dhe artikuj të ndryshëm nga shtypi i huaj mbi gjëndjen në Shqipëri, qëndrimi i shteteve të huaja në Konferencën e Paqes për çështjen shqiptare etj.	-	66	1	Protesta është shkruar nga Pandeli Evangjeli dhe Dhimitër Berati frëngjisht.
10	6	Korespondencë ndërmjet Qeverisë së Përkohshme dhe Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes mbi atentatet kundra Bib Dodës, Prefektit të Beratit, e nënprefektit të Skraparit si dhe vrasja e majorit Ismail Haki Peqinit.	-	11	1	
11	7	Pjesë e shkëputur e programit të Qeverisë Provizore Shqiptare.	-	3	1	Pjesa e shkëputur është në gjuhën frëngjisht.
12	8	Procesverbale të mbledhjeve të Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris si dhe vendime mbi qëndrimin që është mbajtur për problemet e pavarësisë, integritetit dhe mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve ndër viset e okupuara nga shtetet fqinj.	-	96	1	
13	9	Raporte, promemorje dhe korespondencë e Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris drejtuar Kryetarit të Konferencës së Paqes Paris si dhe përfaqësuesve të shteteve të mëdha mbi gjëndjen në Shqipëri, luftën për mbrojtjen e pavarësisë e integritetin tokësor. Kërkohet të mbrohen të drejtat dhe interesat e Shqipërisë kundër qëllimeve të shteteve fqinj e të tjerë për copëtimin e Shqipërisë.	-	375	1	

Nr.	Numri dosjeve	Titulli	Viti (Fillur-Mbaruar)	Sasia e fleteve	Numri i kutise	Shenime
14	9/1	Raporte, promemorie dhe korrespondencë e Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris drejtuar Kryetarit të Konferencës së Paqes Paris si dhe përfaqësuesve të shteteve të mëdha mbi gjëndjen në Shqipëri, luftën për mbrojtjen e pavarësisë e integritetin tokësor. Kërkohej të mbrohen të drejtat dhe interesat e Shqipërisë kundër qëllimeve të shteteve fqinj e të tjerë për copëtimin e Shqipërisë.	-	439	2	
15	10	Protesta nga populli dhe përfaqësues të shoqërive brenda dhe jashtë vëndit drejtuar përfaqësuesve të shteteve të mëdha si dhe Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes mbi mbrojtjen e të drejtave dhe perkohjen e çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes kundër qëllimeve të Serbisë, Greqisë, Italisë për copëtimin e Shqipërisë. Kërkohej që Esat Toptani mos të pranohet si përfaqësues i Shqipërisë në Konferencën e Paqes.	-	320	2	Protestat janë nga rrethet Vlorë, Shkodër, Korçë, Elbasan, Berat, Dibër, Kosovë, Tiranë, Durrës, Ersekë, Mat, Kavajë, Gjirokastër, organizata e gruas dhe studentë shqiptarë në Itali e Zvicër.
16	10/1	Protesta nga populli dhe përfaqësues të shoqërive brenda dhe jashtë vëndit drejtuar përfaqësuesve të shteteve të mëdha si dhe Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes mbi mbrojtjen e të drejtave dhe perkohjen e çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes kundra qëllimeve të Serbisë, Greqisë, Italisë për copëtimin e Shqipërisë. Kërkohej që Esat Toptani mos të pranohet si përfaqësues i Shqipërisë në Konferencën e Paqes.	-	301	2	Protestat janë nga rrethet Vlorë, Shkodër, Korçë, Elbasan, Berat, Dibër, Kosovë, Tiranë, Durrës, Ersekë, Mat, Kavajë, Gjirokastër, organizata e Gruas dhe studentë shqiptar në Itali e Zvicër.
17	11	Ftësë e Shoqërisë të Ekonomisë Sociale Paris për të marrë pjesë në mbledhjen ku do të flitet për Shqipërinë.	-	1	2	Ftesa është dorëshkrim frëngjisht.

Nr.	Numri dosjeve	Titulli	Viti (Fillur-Mbaruar)	Sasia e fleteve	Numri i kutise	Shenime
18	12	Botim dokumentash zyrtarë nga Qeveria e Përkohshme paraqitur para Konferencës së Paqes nga Delegacioni Shqiptar në Paris.	-	121	2	Botimet janë shqip dhe frëngjisht.
19	13	Korespondencë ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes Paris dhe Qeverisë Shqiptare mbi problemet administrative si shtypje materiali, dërgim materialesh, broshura, pasaportash, pritje delegacionesh, shpenzime shtypi, propagande e të ndryshme.	-	110	2	
20	14	Materiale dokumentare paraqitur Konferencës së Paqes për çështjen e Çamërisë - Principata e Epirit.	-	215	3	
21	15	Korespondencë ndërmjet Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes Paris dhe delegacioneve të huaja mbi pretendimet dhe qëllimet e Jugosllavisë për copëtimin e Shqipërisë, masakrat e serbëve ndaj popullit shqiptar sidomos Kosovë, Dibër etj, si dhe materiali për dorëzimin e Ulqinit.	-	117	3	
22	16	Marrëveshje në mes Italisë dhe Greqisë nënshkruar në Paris 29.7.1919 lidhur me copëtimin e Shqipërisë. Protestë e Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes drejtuar Kryetarit të Konferencës së Paqes kundër kësaj marrëveshje.	-	29	3	
23	17	Korespondencë ndërmjet Komitetit Kombëtar Shqiptar në Lozanë, Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes dhe Përfaqësive të Shteteve të Huaja mbi çështjen shqiptare në Konferencën e Paqes Paris.	-	307	3	Ka një protestë nga ky Komitet kundër Esat Toptanit i cili paraqitet si përfaqësues i Shqipërisë në Konferencën e Paqes dhe kundër Turhan Pashës mbasi është i lidhur me Italinë.

Nr.	Numri dosjeve	Titulli	Viti (Fillur-Mbaruar)	Sasia e fleteve	Numri i kutise	Shenime
24	18	Statusi i Shoqërisë Kombëtare Kulturore Shqiptare në Bukuresht si dhe protesta të Kolonisë Shqiptare në Rumani drejtuar Konferencës së Paqes në Paris mbi mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë kundër pretendimeve të shteteve të huaja si dhe veprimtaria e kësaj shoqërie.	-	197	3	
25	19	Korespondencë ndërmjet Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes dhe Shoqërisë Shqiptare " Vatra " mbi veprimtarinë e shoqërisë" Bashkimi" me Parinë Politike dhe programi për çështjen e Shqipërisë.	-	112	3	Ka një letër dorëshkrim të Parashqevi Kyrias drejtuar L.Bumçit .
26	20	Letër e shoqërisë " Bashkimi " në Aleksandri dërguar Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes mbi bindjen që ka kjo shoqëri për mbrojtjen e interesave të Shqipërisë nga ana e delegacionit shqiptar si dhe veprimtaria e kësaj shoqërie.	-	16	3	
27	21	Korespondencë ndërmjet Delegacionit të Kolonisë Shqiptare në Turqi, Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris dhe delegacioneve të tjera mbi përpjekjet për të drejtat e Shqipërisë, theksohet nevoja e bashkimit të popullit pa dallim dhe Esat Toptani mos të njihet si përfaqësues i Shqipërisë në Konferencën e Paqes mbasi ai lufton e bashkëpunon me shtete fqinj kundër interesave të Shqipërisë.	-	116	3	
28	22	Korespondencë ndërmjet Lidhjes Kombëtare Shqiptare në Palermo dhe Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes mbi përpjekjet dhe luftën që bëjnë shqiptarët e Palermos për një Shqipëri të lirë e të pavarur si dhe një thirrje drejtuar Dhomës së Deputetëve Romë nga Lidhja e Kombeve që Italia të mos pranojë copëtimin e Shqipërisë nga grekërit dhe sërëbet.	-	15	3	

Nr.	Numri dosjeve	Titulli	Viti (Fillur-Mbaruar)	Sasia e fleteve	Numri i kutise	Shenime
29	23	Traktat ndërmjet shteteve të ndryshme të botuara nga Lidhja e Kombeve.	-	24	3	
30	24	Njoftime të ndryshme të Delegacionit Lituanëz në Konferencën e Paqes Paris dëguar delegacionit shqiptar mbi veprimtarinë e këtij delegacioni për problemet e tyre.	-	148	3	
31	25	Relacion (kopje) i Tofik Mborjes mbi vizitën e konsullit amerikan në Shqipëri.	-	4	3	Relacioni është kopje në gjuhën italisht.
32	29	Letër drejtuar Sulejman Delvinës nga i dërguari i posaçëm i Komitetit të Kolonisë Shqiptare të Turqisë mbi mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë sipas programit e betimit të bërë nga ana e tyre.	-	1	3	Shtesë
33	30	Kërkesat e Shqipërisë përpara Kongresit të Paqes për mbrojtjen e kombit shqiptar nga fqinjët që kërkojnë të luftojnë.	-	9	3	Shtesë
34	31	Shtojcë e delegacionit shqiptar parashtruar Klemensonit, Kryetar i Konferencës së Paqes mbi rivendikimet shqiptare mbi Çamërinë (fondi mungon) dhe kërkesat për mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë kundër Italisë dhe Serbisë.	-	2	3	Shtesë
35	32	Protestë kundër Serbisë e Reshit Dinos delegat i Federatës Shqiptare " Vatra " në Amerikë drejtuar Vilsonit President i SH.B.A. për mbrojtjen e Kosovës.	-	1	3	Shtesë
36	33	Protestë e delegacioneve të kolonisë shqiptare të Turqisë, Rumanisë dhe Amerikës drejtuar Vilsonit , President i SH.B.A. kundër pushtimit të Vlorës nga Italia etj. dhe kërkojnë mandatin amerikan mbi Shqipërinë (kopje).	-	2	3	Shtesë
37	34	Delegacion shqiptar i kërkon një gazete italiane të botojë apelin drejtuar parlamentit italian për mosaneksimin e Vlorës nga Italia dhe të Gjirokastrës nga Greqia.	-	1	3	Shtesë

Nr.	Numri dosjeve	Titulli	Viti (Fillur-Mbaruar)	Sasia e fleteve	Numri i kutise	Shenime
38	35	Protestë e Turhan Pashës drejtuar kryeredaktorit të gazetës " Les Debast " në Paris mbi botimin e shpifjes së Karapanos për trajtim të keq të të krishterëve shqiptarë nga ana e qeverisë.	-	2	3	Shtesë
39	36	Relacion mbi hedhjen poshtë të argumentave tendencioze të kryeministrit grek Venizellos për Epirin e Veriut mbas Traktatit të Fshehtë të Londrës drejtuar Anglisë, Francës dhe Amerikës për të marrë vendim kundër këtij traktati.	-	7	3	Shtesë
40	37	Marrëveshja e 29 korrikut të vitit 1919 midis Greqisë dhe Italisë për copëtimin e Shqipërisë (kopje) nënshkruar nga Venizellos - Titoni.	-	6	3	Shtesë
41	38	Letër e Ali Muhamet Vlorës dërguar Delegacionit Shqiptar në Francë për të ndërmjetësuar pranë qeverisë franceze për lirin e djalit të tij të burgosur nga francezët në shpalljen e luftës në mes Francës e Turqisë.	-	1	3	Shtesë
42	39	Delegacioni shqiptar në Konferencën e Paqes i drejtohet Senatit Amerikan për mbrojtjen e popullit shqiptar që kërcënohet nga fqinjët e tij.	-	2	3	Shtesë
43	40	Telegrame falenderimi i Haxhi Murat Camit dhe Rasih Dino nga Amerika dërguar delegacionit shqiptar në Paris për përpjekjet e tij për bashkimin e Çamërisë dhe Kosovës në Shqipëri.	-	2	3	Shtesë
44	42	Letra të patriotëve shqiptarë në të cilat dënohet ndërhyrja e italianëve në punët e brendshme të Shtetit Shqiptar si dhe dobësia e qeverisë vendase për ti frenuar ato.	04.21.1919 - 06.12.1919	4	1	Shtesë
45	43	Procesverbal i mbledhjes së delegacionit shqiptar në Konferencën e Parisit ku shqyrtohet mandati italian në Shqipëri.	09.30.1919	9	1	Shtesë

Nr.	Numri dosjeve	Titulli	Viti (Fillur-Mbaruar)	Sasia e fleteve	Numri i kutise	Shenime
46	44	Protestë e delegatëve të Kolonisë Shqiptare në Konferencën e Parisit dërguar Kryetarit të Konferencës së Paqes Klemensonit me anën e së cilës kërkojnë ruajtjen e integritetit të tokave shqiptare.	06.18.1919	2	1	Shtesë
47	45	Protestë e P. Evangjelit përfaqësuesi i shqiptarëve me banim në Rumani dërguar Kryetarit të Konferencës në Paris lidhur me situatën e popullsisë ortodokse të Gjirokastrës e të Korçës dhe ekuipazhin e këtyre zonave nga trupat greke.	07.05.1919	4	1	Shtesë
48	46	Korrespondencë e Drejtorit të Postave Shkodër me Komandën e Trupave Aleate, kontrollorin e postave dhe Drejtorinë e Financave Shkodër, mbi vështirësitë që po i dalin në Paris dhe nevojën për të holla për emetimin e pullave shqiptare.	10.27.1919 - 11.28.1919	4	1	Shtesë
49	48	Telegram drejtuar Shoqatës së Bukureshtit nga Vlora, Milano, Aleksandria ku protestohet kundër coptimit të Shqipërisë dhe ruajtjen e trojeve shqiptare.	-	6	1	
50	3	Ekonomi - Financë.				
51	26	Korespondencë ndërmjet Delegacionit Shqiptar në Paris dhe Ministrisë së Post - telegrafeve të Parisit mbi ndihmën që kërkon Qeveria Provizore për riorganizimin e Post - Telegrafave të Shqipërisë duke i dërguar ligjet e rregulloret që ka Franca.	-	1	3	
52	27	Konventë mbi rregullimin e lundrimit aeror të vitit 1919 si dhe një protokoll mbi ndryshimin e një artikulli (34) të kësaj konvente.	-	38	3	

Nr.	Numri dosjeve	Titulli	Viti (Fillur-Mbaruar)	Sasia e fleteve	Numri i kutise	Shenime
53	28	Korespondencë ndërmjet Kryetarit të Qeverisë së Përkohshme dhe Kryetarit të Delegacionit në Konferencën e Paqes Paris Turhan Pasha me kryetarin adinterin të Qeverisë së Përkohshme Durrës mbi ndihmë për të shoqen e Themistokli Gërmenjit.	-	1	3	
54	49	Shtypshkronja e Bashkisë i paraqet Delegacionit Shqiptar llogarinë që ka bërë për shtypjen e notave të tija.	1919	6	1	
55	4	Shtesë.				
56	41	Projekt i Shoqërisë së Kombeve mbi të drejtën ndërkombëtare për çështjen e çarmatimit.	04.28.1919	0	1	Shtesë II